



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 305, datë 13.07.2021

PËR
CAKTIMIN NË SKEMËN E DELEGIMIT TË GJYQTARES
ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 45 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesës së gjyqtares znj. {...}, protokolluar me aktin nr. 3157, datë 05.07.2021, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...}.
2. Caktimin e gjyqtares znj. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.
3. Përfundimin e gjyqtares znj. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
4. Dorëzimin menjëherë nga gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} të të gjitha çështjeve gjyqësore që i janë ngarkuar për të gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, si gjyqtar i vetëm apo si kryetar i trupit gjykues, për të cilat nuk ka filluar hetimi gjyqësor.
5. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, si kryetare apo anëtare e trupit gjykues, për të cilat hetimi gjyqësor është në një fazë të avancuar.
6. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} ngarkohet të përfundojë edhe ato çështje gjyqësore që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, si kryetare apo anëtare e trupit gjykues, për të cilat hetimi gjyqësor nuk është në një fazë të avancuar, nëse nga vlerësimi rast pas rasti edhe nga Kryetari i Gjykatës arrihet në përfundimin se zëvendësimi i saj:
 - a) është i pamundur të bëhet me gjyqtarët e tjerë të gjykatës;
 - b) krijon problematika të rënda për ecurinë e gjykimit; ose
 - c) dëmton në mënyrë të pariparueshme dhënien e drejtësisë.
7. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.

8. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR